

Ligji nr. 10 192, datë 3.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë"

Qëllimi i këtij ligji është parandalimi dhe goditja ndaj krimit të organizuar dhe trafikimit përmes konfiskimit të pasurisë së personave, të cilët kanë një nivel të pajustificuar ekonomik, si rezultat i veprimtarisë së dyshuar kriminale.

Fusha e zbatimit e këtij ligji mbulon pasuritë e personave, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, bazuar në indicie, për pjesëmarrje në organizata kriminale apo terroriste, ose për kryerje të disa veprave penale si, për shembull, rrëmbim personi, trafikim femrash a të miturish etj. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të afërm dhe personave të tjerë kur pasuritë e këtyre të fundit kanë lehtësuar apo ndihmuar në kryerjen e veprimtarive të paligjshme. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të krijuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, me kusht që pasuritë të jenë vënë gjatë përfshirjes së dyshuar të tij në veprimtarinë kriminale, sipas këtij ligji.

I. Llojet e masave parandaluese dhe kushtet e vendosjes së tyre

Në kuptim të këtij ligji, masë parandaluese është çdo masë me karakter pasuror që gjykata vendos në një procedim gjyqësor nëpërmjet sekuestrimit të pasurive, veprimtarisë ekonomike, tregtare dhe profesionale të personave (A), si dhe nëpërmjet konfiskimit të tyre (B).

A. Sekuestrimi i pasurisë

Me kërkesë të motivuar të prokurorit, gjykata vendos ^[1] **sekuestrimin** e pasurive të personit kur janë të plotësuara këto kritere:

- Ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se personi mund të jetë i përfshirë në veprimtari kriminale;
- Zotërimi i pasurive apo pasja e një niveli jetese që nuk i përgjigjet dukshëm nivelit të të ardhurave apo veprimtarive ekonomike të deklaruara;
- Përbushja e njërit prej kushteve të mëposhtëm: Dse ekziston një rrezik real i humbjes apo tjetërsimit të pasurive mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së sekuestrimit;

Dse ka dyshime të arsyeshme që këto pasuri të përdoren nga apo të lehtësojnë veprimtari kriminale.

[1] Sekuestrimi është një masë konservative **me karakter të përkohshëm** që mundëson vënien në dorën e organeve të drejtësisë të një shume parash, të një sendi të luajtshtëm apo të paluajtshtëm **për ta bërë të padisponueshëm**, duke siguruar kështu ruajtjen e tij, gjer me ndërhyrjen e vendimit gjyqësor.

B. Konfiskimi i pasurisë

Masa e **konfiskimit**^[2] vendoset me kërkesën e motivuar të prokurorit. Në përgjithësi, konfiskimi kërkohet për pasuri të vëna nën sekuestrim por jo domosdoshmërisht.

Gjykata pranon kërkesën për konfiskim kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm, i bazuar në indicie, që tregon se personi mund të jetë pjesëmarrës në veprimtari kriminale
- Pasuria është, drejtpërdrejt ose tërthorazi, në zotërimin e pjesshëm apo të plotë të personit
- Pasuria e zotëruar prej personit nuk provohet se ka prejardhje të ligjshme ose niveli i tij i pasurisë nuk justifikohet nga veprimtaritë ekonomike të ligjshme, të deklaruara prej tij.

Guri qëndror i këtij ligji ka të bëjë pikërisht me faktin se **barra e provës**, për të vërtetuar se pasuritë janë fituar në mënyrë të ligjshme, i përket personit kundër pasurive të të cilit kërkohet konfiskimi. Elementi tjetër i rëndësishëm lidhet me **autonominë e masës së konfiskimit** kundrejt proçedimit penal apo vendime gjyqësore penale. Kështu, gjykata kompetente për shqyrtimin e masës parandaluese mund të vendosë konfiskimin e pasurisë edhe kur pushohet proçedimi penal kundër personit, kur ky deklarohet i pafajshëm ose kur vepra penale për të cilën ai akuzohet rikualifikohet në një vepër penale jashtë fushës së zbatimit të këtij ligji.

II. Procedura e vendosjes së masave parandaluese

Përpara se të trajtojmë procedurën e vendosjes së masave parandaluese, në kuptimin e mirëfilltë, duhet që paraprakisht të ripërmendim se ajo është e pavarur nga gjendja apo përfundimi i proçedimit penal që zhvillohet në ngarkim të personave ndaj pasurisë së të cilëve kërkohen të merren masat në fjalë. **Vënia në lëvizje e prokurorisë ose e policisë gjyqësore** mund të bëhet kryesisht ose me njoftimin e bërë nga të tretët. Kërkesa e prokurorit për marrjen e masave parandaluese shqyrtohet, në shkallë të parë, nga gjykatat e shkallës së parë të krimeve të rënda dhe, në shkallë të dytë, nga gjykatat e apelit të krimeve të rënda.

Verifikimet, hetimet dhe gjykimi, për zbatimin e këtij ligji i nënshtrohen, përveç rregullave proçeduriale të parashikuara nga ai vetë, **Kodit të proçedurës civile** dhe, çuditërisht, jo Kodit të proçedurës penale, kur ndërkohë objekti i ligjit janë pasuritë e personave të dyshuar për kryerje krimesh. Afati për shqyrtimin e kërkesës, nga ana e Gjykatës, për vendosjen e masës parandaluese, është 5 ditë për sekuestrimin dhe 3 muaj për konfiskimin, por që mund të zgjatet deri në 1 vit për rastet e ndërlikuara.

[2] Konfiskimi është **shpronësimi i përhershëm** i një pasurie private në favor të shtetit për arsye të shkeljes së ligjit dhe pa dëmshpërblim.

Pasuritë e sekuestruara ose të konfiskuara i kalojnë nën administrim Agjencisë së Administrimit të Pasurive të sekuestruara dhe të Konfiskuara. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim sipas afateve dhe kushteve të parashikuara nga Kodi i procedurës civile.

Në rast se vendimi për konfiskim merr formë të prerë, pasuritë e konfiskuara kalojnë në pronësi të shtetit në mënyrë të pakthyeshme. Nëse në vijim ish-zotëruesi i tyre provon paligjshmërinë apo pabazueshmërinë e konfiskimit, atëherë ai mund të kërkojë vetëm zhdëmtin e drejtë.

Av. Armer JUKA